

VENDIM
Nr. 83, datë 19.3.2026

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “SUNNY SIDE ENERGY” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË
E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “d”, 5, pika 1, germa “d”, dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.3.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 856/2 prot., datë 18.3.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Sunny Side Energy’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Sunny Side Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 856 prot., datë 9.3.2026, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në pikën 1.1, për gjerat: “a”, “b” dhe “c”; në pikën 1.2, për gjerat “a” dhe “d”; në pikën 1.3, për gjerën “a”; në pikën 2.4, për gjerat: “a”, “b” dhe “d”.

Shoqëria duhet të plotësojë më tej informacionin/dokumentacionin si vijon:

Neni 9. Format i dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2. Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- germa “b”: shoqëria duhet të depozitojë dëshminë e penaltetit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për administratorin dhe vetë shoqërinë;

- germa “c”: shoqëria ka depozituar strukturën e saj organizative në gjuhën angleze. Në referencë të përcaktimeve të nenit 8, pika 3, të rregullores, ky dokument duhet të depozitohet në gjuhën shqipe.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- germa “b”: shoqëria duhet të dokumentojë mbështetjen financiare për të garantuar ushtrimin e të paktën 1 (një) muaji të veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike, në përputhje me përcaktimet e rregullores dhe të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 16, datë 16.1.2025, duke bazuar përllogaritjen për mbështetjen financiare që i nevojitet për të garantuar ushtrimin e të paktën 1 muaji të veprimtarisë në sasinë e energjisë së parashikuar dhe çmimin mujor të Ditës në Avancë të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX) për muajin që i paraprin datës së aplikimit;

- germa “c”: shoqëria duhet të përditësojë planin e biznesit duke reflektuar mënyrën e financimit të ushtrimit të veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike, si dhe dokumentacion provues përkatës. Dokumenti i përditësuar duhet të depozitohet në ERE.

Pika 2.4. Dokumentacioni specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike

- germa “c”: shoqëria duhet të japë informacion mbi disponimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit për të 5 vitet e vlefshmërisë së licencës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Sunny Side Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Originës të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti